

Vendim nr. 262, datë 27.07.2026

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Marsida Xhaferllari, Kryesuese

Ilir Toska, Anëtar

Genti Ibrahimi, Anëtar

në datën 27.07.2026 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 2 (Q) 2026 të Regjistrimit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: **QATIP BASHO, JETA BUSHAJ**, përfaqësuar nga avokati Fuat Muka, me prokurë të posaçme.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 179 (87-2023-285), datë 28.12.2023 të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 00-2025-1407, datë 23.09.2025 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 15, 41, 42, 131, shkronja “f”, dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 50, pika 4, dhe 71/a të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Marsida Xhaferllari, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese të saj, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesit janë në marrëdhënie familjare mes tyre, përkatësisht vjehërr dhe nuse. Konkretisht, kërkuesi i parë Qatip Basho është i ati i bashkëshortit të kërkueses së dytë Jeta Bushaj.

2. Dy djemtë e kërkuesit të parë (njëri prej të cilëve bashkëshorti i kërkueses së dytë) janë përfshirë në veprimtari kriminale, për shkak të së cilës ndaj tyre është zbatuar akti normativ nr. 1, datë 31.01.2020 “Për masat parandaluese në kuadër të forcimit të luftës kundër terrorizmit, krimit të organizuar, krimeve të rënda dhe konsolidimit të rendit dhe të sigurisë publike” (*akti normativ për OFL-në*). Konkretisht, njëri prej tyre (bashkëshorti i kërkueses së dytë), me vendimin e datës 08.11.2016 të Gjykatës së Torinos, Itali është dënuar me burgim të përjetshëm për veprat penale të vrasjes, të shfrytëzimit të prostitucionit dhe mbajtjes e transportimit pa leje të armëve të zjarrit, të parashikuara nga nenet 81, 110, 61 dhe 575 të Kodit Penal italian, si dhe nga paragrafët 10, 12 dhe 14 të ligjit italian nr. 497/1974. Ndërsa shtetasi tjetër, vëllai i tij, është dënuar me 15 vjet burgim nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë me vendimin e datës 17.03.2008, për veprat penale të vrasjes me paramendim, të mbetur në tentativë, dhe mbajtjes pa leje të armëve luftarake, të parashikuara nga nenet 78, paragrafi i parë e 22 dhe 278, paragrafi i dytë, të Kodit Penal (KP), dënim i cili është ulur në 8 vjet burgim nga Gjykata e Lartë me vendimin e datës 15.09.2010.

3. Sipas informacionit të mbledhur nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, ka rezultuar, ndër të tjera, se kërkuesi i parë është pronar i një apartamenti me sipërfaqe 57 m², të ndodhur në qytetin e Vlorës, të blerë me kontratën e datës 21.03.2017 kundrejt çmimit prej 18.000 eurosh, si dhe i një automjeti të blerë më 18.12.2017 kundrejt çmimit prej 1.000 eurosh. Ndërsa kërkuesja e dytë rezulton të jetë titullare e një llogarie bankare, të çelur më 27.06.2017, me gjendje prej 98.849,99 lekësh, si dhe pronare e një automjeti të blerë më 26.05.2019 kundrejt çmimit prej 1.056.600 lekësh.

4. Gjithashtu, sipas vetëdeklarimit të kërkueses së dytë, familja Basho ka në pronësi një banesë dykatëshe në Selenicë, të regjistruar më 08.12.1994, me sipërfaqe banimi 90 m², e palegalizuar dhe me vlerë investimi 5.412.000 lekë. Sipas deklarimeve të saj, ndërtimi i kësaj banese është financuar me ndihmën e familjarëve dhe të bashkëshortit të saj, i cili jeton në emigrim, përfshirë edhe dajën e këtij të fundit. Nga verifikimet e Policisë së Shtetit ka rezultuar se daja i bashkëshortit ishte detyruar, nëpërmjet kanosjes, nga njëri prej djemve të kërkuesit të parë të

dorëzonte shumë prej 28.000 eurosh. Për këtë fakt, në vitin 2017 është regjistruar procedimi penal për veprën penale të shtrëngimit me anë të kanosjes ose të dhunës për dhënien e pasurisë, të parashikuar nga nenet 109/b dhe 25 të KP-së.

5. Pas kryerjes së verifikimeve mbi burimet financiare për krijimin e tetë pasurive në fjalë, ku përfshiheshin edhe pesë pasuritë e sipërpërmendura, autoritetet kanë konstatuar mungesën e të ardhurave të ligjshme dhe të mjaftueshme për të justifikuar krijimin e tyre. Për rrjedhojë, është krijuar dyshimi i arsyeshëm se këto pasuri rridhnin nga aktiviteti kriminal i dy vëllezërve. Mbi bazën e këtyre të dhënave, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, më 30.09.2020, i ka përcjellë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (*Prokuroria e Posaçme*) kërkesën për sekuestrimin e tetë pasurive.

6. Në vijim, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (*GJKKO-ja e Shkallës së Parë*), me vendimin nr. 181, datë 04.11.2020, ka vendosur, ndër të tjera, sekuestrimin e banesës dykatëshe në pronësi të familjes Basho, të apartamentit në pronësi të kërkuesit të parë, të llogarisë bankare në emër të kërkueses së dytë, si dhe të dy automjeteve në pronësi të kërkuesve. Pas përfundimit të hetimeve, Prokuroria e Posaçme i është drejtuar gjykatës me kërkesë për konfiskimin e këtyre pasurive. GJKKO-ja e Shkallës së Parë, me vendimin nr. 25, datë 08.02.2023, ka vendosur konfiskimin e banesës dykatëshe, të llogarisë bankare dhe të automjetit në pronësi të kërkueses së dytë, ndërsa ka hequr masën e sekuestros ndaj apartamentit dhe automjetit në pronësi të kërkuesit të parë.

7. Ndonëse kërkuesit kanë paraqitur ankim, vendimi është lënë në fuqi nga Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (*GJKKO-ja e Apelit*) me vendimin nr. 179 (87-2023-285), datë 28.12.2023, ndërsa Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2025-1407, datë 23.09.2025, ka vendosur mospranimin e rekursit.

8. Në datën 07.05.2026 kërkuesit i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të Ligjit Organik të Gjykatës, është regjistruar më 18.05.2026.

II

Pretendimet e kërkuesve

9. **Kërkuesit**, në mënyrë të përmblodhur, kanë pretenduar se nga vendimet e kundërshtuara u janë cenuar:

- 9.1. *E drejta e pronës*, e garantuar nga neni 41 i Kushtetutës, pasi gjykatat kanë konfiskuar edhe banesën dykatëshe, e cila është blerë nga një person tjetër që në vitin 1992 dhe çmimi është likuiduar pjesërisht, por ende nuk është ligjësuar te noteri. Për shkak se blerësi ka ndërruar jetë nuk është bërë i mundur realizimi i aktit të shitjes dhe transkriptimi i pronës. Kjo pasuri figuron e regjistruar në emër të atij personi me datë regjistrimi 08.12.1994. Nga analiza financiare e ekspertit kontabël dhe nga balancat financiare nuk është evidentuar në asnjë moment pamundësia financiare e kërkuesve për të ndërtuar pasurinë në fjalë. Kërkuesi i parë së bashku me bashkëshorten e tij, për shkak të të ardhurave nga punësimi dhe shitja e pasurive të tjera të përfituara pas viteve 1990 nga ligjet e kohës, kanë pasur mundësi të mjaftueshme financiare për të blerë në vitin 1994 një banesë njëkatëshe, rikonstruksioni i së cilës ka filluar në vitin 2018, pasi ishin mbledhur ndër vite të ardhura nga punësimi. Shtesa e banesës i është lënë për strehim njërit prej djemve së bashku me bashkëshorten e tij (kërkuesja e dytë). Kurse, sipas kërkueses së dytë, pasuritë janë krijuar nga të ardhurat e emigracionit prej 12 vjetësh në Itali, si dhe ndihmat nga të afërmit.
- 9.2. *E drejta për proces të rregull ligjor*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në aspektet e mëposhtme:
- 9.2.1. *Parimi i barazisë së armëve*, pasi gjykatat nuk kanë marrë në konsideratë provat e tyre që dëshmojnë se kanë pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për të krijuar pasuritë e konfiskuara.
- 9.2.2. *Standardi i arsyetimit të vendimit gjyqësor*, pasi gjykatat nuk kanë arsyetuar nga pikëpamja përmbajtësore vendimmarrjen e tyre, duke bërë që arsyetimi të ketë të meta serioze.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkuesve

10. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f”, dhe 134, pikat 1, shkronja “i”, dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast,

duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

11. Kriteret paraprake të legjitimitimit janë të natyrës kumulative, ndaj, në këtë këndvështrim, mjafton mosplotësimi edhe i njërit prej tyre që kërkuuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues. Gjatë shqyrtimit paraprak të çështjes vlerësohet plotësimi i një ose më shumë kriterëve të legjitimitimit, në varësi të elementeve dhe veçantive të çështjes konkrete, me qëllim që vendimi të jetë sa më i qartë dhe shterues për kërkuuesin. Thënë ndryshe, mund të ndodhë që në shqyrtimin paraprak të një çështjeje të verifikohet mospërmbushja edhe vetëm e një kriteri, duke sjellë si pasojë moskalimin e saj në seancë plenare.

12. Në rastin konkret, Kolegji çmon se analiza duhet të përqendrohet në kriterin e legjitimitimit *ratione materiae*, i cili lidhet me natyrën kushtetuese të pretendimeve të parashtruara nga kërkuuesit. Në këtë kuadër, ata kanë pretenduar cenimin e së drejtës së pronës, si dhe së drejtës për një proces të rregullt ligjor, konkretisht në aspektin e parimit të barazisë së armëve dhe të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor.

13. Në lidhje me cenimin e *së drejtës së pronës*, kërkuuesit kanë parashtruar se ata kanë pasur të ardhura të ligjshme për krijimin e pasurive të konfiskuara të prejardhura nga punësimi, nga shitja e pasurive të tjera, nga emigracioni, si dhe nga ndihma e të afërmeve të tyre.

14. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se vendosja e kufizimeve mbi të drejtën e pronës në kuadër të procedurave ligjore zakonisht lidhet me kontrollin e ushtrimit/ përdorimit të pronës, kontroll ky nga autoritetet publike, i cili duhet të jetë i ligjshëm, duhet të ndjekë një qëllim të ligjshëm dhe midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit të ndjekur duhet të ketë një marrëdhënie të arsyeshme proporcionaliteti (*shih vendimet nr. 29, datë 16.04.2024; nr. 18, datë 19.03.2024 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykatës nuk i takon të zëvendësojë gjykatat e zakonshme në rivlerësimin e fakteve dhe të provave të administruara prej tyre, por të verifikojë nëse ato kanë zbatuar standardet kushtetuese të mbrojtjes së pronës, nëse kanë dhënë arsye të mjaftueshme për ndërhyrjen në këtë të drejtë dhe nëse kufizimi i vendosur paraqitet arbitrar ose haptazi joproporcional (*shih vendimin nr. 29, datë 26.01.2026 të Mbledhjes së Gjyqtarëve*).

15. Nën dritën e këtyre standardeve, Kolegji vëren se procedura e konfiskimit është vënë në lëvizje me kërkesë të Prokurorisë së Posaçme, e cila është pranuar nga GJKKO-ja e Shkallës së

Parë. Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, kjo gjykatë ka arritur në përfundimin se kërkuesit nuk arritën të provonin burimin e ligjshëm të krijimit të pasurive objekt konfiskimi, pasi nuk justifikuan me dokumentacion ligjor të ardhurat e nevojshme për krijimin e tyre.

16. Gjatë gjykimit, GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka administruar, ndër të tjera, aktin e ekspertimit kontabël, si dhe ka lejuar të dyja palët të paraqisnin prova shkresore në mbështetje të pretendimeve të tyre, duke ia nënshtuar ato debatit gjyqësor. Në analizën e saj, gjykata është mbështetur në përllogaritjen e të ardhurave dhe shpenzimeve të kërkuesit të parë dhe të bashkëshortes së tij për periudhën 01.01.2007–31.12.2017, si dhe në shpenzimet e konsumit familjar deri në vitin 2020. Po kështu, ajo ka analizuar të ardhurat dhe shpenzimet e kërkueses së dytë për periudhën 2011–2020, duke marrë në konsideratë vetëm të ardhurat e provuara me dokumentacion të rregullt zyrtar dhe të dhënat statistikore të INSTAT-it.

17. Në mënyrë të veçantë, për sa i përket banesës dykatëshe, gjykata ka konstatuar se, ndonëse kërkuesi i parë kishte vetëdeklaruar një investim në vlerën 5.412.000 lekë, ai nuk kishte paraqitur dokumentacion që të provonte mënyrën e fitimit të saj, përfshirë kontratën e blerjes nga poseduesi i mëparshëm. Në përfundim, gjykata ka vlerësuar se kërkuesit nuk kishin justifikuar me të ardhura të ligjshme mundësinë financiare për krijimin e pasurive të sekuestruara dhe se mungonte dokumentacioni provues që të mbështeste deklaratimet e tyre mbi burimin e mjeteve monetare. Për rrjedhojë, ajo ka arritur në përfundimin se të ardhurat e ligjshme të deklaruara nuk mbulonin koston e krijimit ose të blerjes së pasurive të konfiskuara, të cilat rezultonin të ishin krijuar në mënyrë të pajustificuar në raport me nivelin e të ardhurave të ligjshme të provuara.

18. Në të njëjtën linjë, edhe GJKKO-ja e Apelit ka arsyetuar se, në rastin konkret, plotësoheshin të tria kushtet e parashikuara nga neni 23 i aktit normativ për OFL-në. Sipas saj, dy vëllezërit ishin subjekte të këtij akti, ndërsa kërkuesit, si familjarë të tyre, nuk arritën të rrëzonin prezumimin ligjor për regjistrimin e rremë të pasurive dhe as të provonin origjinën e ligjshme të burimeve të përdorura për krijimin e tyre. Për rrjedhojë, gjykata arriti në përfundimin se pasuritë objekt gjykimi ishin dukshëm të shpërpjesëtuara me nivelin e të ardhurave të ligjshme të kërkuesve.

19. Ky arsyetim nuk është cenuar nga Gjykata e Lartë, e cila ka vlerësuar se shkaqet e ngritura në rekurs ishin të njëjta me ato të parashtruara në ankim dhe se për to kërkuesit kishin marrë përgjigje të plotë dhe të arsyetuar nga GJKKO-ja e Apelit. Sipas Gjykatës së Lartë, kërkuesit kishin përsëritur të njëjtat pretendime edhe në rekurs, pa paraqitur ndonjë argument ose shkak

ligjor që të vinte në dyshim ligjshmërinë e vendimeve të gjykatave të faktit. Në këtë drejtim, ajo ka vlerësuar se gjykatat e faktit kishin analizuar dhe argumentuar në mënyrë të plotë përmbushjen e kushteve të nenit 23 të aktit normativ për OFL-në, duke konstatuar se: (i) për pasuritë ishte vendosur masa e sekuestros; (ii) ekzistonin dyshime të arsyeshme, të mbështetura në elemente konkrete fakti, për përfshirjen e dy vëllezërve në veprimtari kriminale, për të cilat ata ishin dënuar dhe që përfshiheshin në nenin 5, pika 1, shkronja “c”, të aktit normativ për OFL-në; (iii) pas administrimit të aktit të ekspertimit financiar gjykatat kishin kryer një analizë të detajuar të mundësive financiare dhe të burimeve të ligjshme të kërkuesve, duke arritur në përfundimin se ata nuk kishin provuar origjinën e ligjshme të pasurive objekt konfiskimi.

20. Në përfundim, Gjykata e Lartë ka çmuar se GJKKO-ja e Apelit e kishte arsyetuar në mënyrë të mjaftueshme vendimin e saj, në përputhje me kërkesat procedurale. Sipas saj, kjo gjykatë kishte evidentuar dhe vlerësuar faktet dhe provat mbi të cilat mbështetej vendimmarrja, si dhe kishte dhënë përgjigje të plotë dhe të arsyetuar ndaj pretendimeve të paraqitura nga kërkuesit gjatë gjykimit dhe në ankim.

21. Nga sa më sipër, Kolegji konstaton se gjykatat e juridiksionit të zakonshëm u kanë dhënë kërkuesve përgjigje lidhur me kufizimin e së drejtës së tyre të pronës. Ato kanë arsyetuar se masa e konfiskimit ishte vendosur në bazë të ligjit, ndiqte një interes publik legjitim dhe respektonte parimin e proporcionalitetit, pasi ishte zbatuar vetëm ndaj atyre pasurive, për të cilat kërkuesit nuk arritën të provonin se ishin krijuar me të ardhura të ligjshme. Në këtë drejtim, gjykatat kanë vlerësuar se ndërhyrja nuk është shtrirë në mënyrë të përgjithshme mbi të gjitha pasuritë e kërkuesve, pasi pasuritë e regjistruara në emër të kërkuesit të parë janë përjashtuar nga konfiskimi dhe ndaj tyre është hequr masa e sekuestros.

22. Kolegji evidenton gjithashtu se vlerësimi nëse kërkuesit kanë provuar ose jo origjinën e ligjshme të të ardhurave të përdorura për krijimin e pasurive përbën çështje të interpretimit të ligjit dhe të vlerësimit të provave, kompetencë që, në parim, u përket gjykatave të juridiksionit të zakonshëm (*shih vendimet nr. 63, datë 20.11.2023; nr. 68, datë 14.11.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Në mungesë të ndonjë gabimi të dukshëm në përcaktimin e fakteve ose në zbatimin e ligjit, që do ta bënte masën e konfiskimit arbitrare, Kolegji çmon se pretendimi i kërkuesve për cenimin e së drejtës së pronës është haptazi i pabazuar.

23. Në lidhje me pretendimin për cenimin së drejtës për *proces të rregullt ligjor* në aspektet e *barazisë së armëve* dhe të *standardit të arsytimit*, kërkuesit kanë parashtruar se gjykatat nuk

kanë pranuar provat e tyre dhe se arsyetimi i vendimeve ka të meta serioze (*shih sipër paragrafin 9.2.*).

24. Kolegji vëren se, ndryshe nga sa pretendojnë kërkuessit, ata kanë marrë pjesë në të gjitha shkallët e procesit gjyqësor të zhvilluar në lidhje me pasuritë objekt konfiskimi dhe janë përfaqësuar nga mbrojtës të zgjedhur prej tyre. Gjatë këtij procesi, atyre u është garantuar mundësia të paraqesin kërkesa procedurale, të administrojnë prova në mbështetje të pretendimeve të tyre dhe të marrin përgjigje të arsyetuar për to.

25. Po kështu, Kolegji konstaton se arsyetimi i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm nuk ka qenë formal, por pasqyron rrethanat e çështjes, provat e administruara, pretendimet e palëve dhe bazën ligjore mbi të cilën është mbështetur zgjidhja e mosmarrëveshjes. Edhe vendimi i Gjykatës së Lartë, ndonëse me arsyetim të kufizuar, përmbush standardet kushtetuese (*shih vendimet nr. 30, datë 02.05.2025; nr. 10, datë 07.03.2023; nr. 37, datë 19.09.2011 të Gjykatës Kushtetuese*), pasi në pjesën hyrëse evidentohen shkaqet e rekursit dhe në përmbajtje jepen arsye thelbësore të mospranimi të tij. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkuessve për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor është haptazi i pabazuar.

26. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.